



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

KKDM/Nr. ....90..... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më 22/09/2022

**VENDIM**

Nr.24, date 22 /09/2022

**PËR**

**RAPORTIN 6 MUJOR NE LIDHJE ME GJENDJEN, MONITORIMIN, MIREMBAJTJEN DHE  
SIGURINE E DIGAVE DHE REZERVUAREVE TE KASKADES SE LUMIT DRIN QE  
ADMINISTROHEN NGA KESH**

Në mbështetje te Ligjit Nr. 8681, datë 02.11.2000 "Për Projektimin, Ndertimin, Shfrytezimin dhe Mirembajtjen e Digave dhe Dambave" dhe VKM Nr. 147, datë 18.03.2004 "Miratimin e Rregullores për Sigurinë e Digave dhe të Dambave", Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha (KKDM) në mbledhjen e dates 22.09.2022 mori në shqyrtim Raportin e 6 Mujoit te pare te vitit 2022 per gjendjen, monitorimin, mirembajtjen dhe sigurine e digave dhe rezervuareve te kaskades se lumi Drin qe administrohen nga KESH. Ne mbledhje ishin prezent edhe perfaquesues te DSD/KESH. Gjatë mbledhjes u diskutua në lidhje me disa problematika te konstatuara gjate shqyrtimit te ketij reporti si dhe kerkesave te KKDM ne lidhje me permiresimin e procesit te monitorimit, shfrytezimit dhe sigurise se digave dhe ne menyre te vecante monitorimin e masiveve rreshqites te konstatuara ndër vite pranë këtyre digave. Ceshtjet e trajtuara ishin:

- Gjendja aktuale e masiveve rreshqites pranë diges se HEC Fierze dhe diges se HEC Koman dhe problematikat e monitorimit te tyre
- Ecuria e projektit te financuar nga qeveria Zvicerane (Amenndamenti 2) per Sigurne e digave te kaskades se lumi Drin
- Ecuria e zbatimit te projektit te financuar nga Banka Boterore dhe KfW ne lidhje me rehabilitimin e sistemeve te shkarkimit ne HEC Fierze, HEC Koman, dhe HEC Vau I Dejes.
- Përditesimi i rregullores se shfrytezimit, monitorimit dhe kontrollit te digave dhe rezervuarave te kaskades se lumi Drin sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe udhezimeve te dhena permes Vendimit te KKDM Nr. 3, dt.19.10.2020.
- Vlerësimet e aseteve te digave dhe elementeve kryesore hidraulike te tyre

Gjate diskutimeve qe u kryen, perfaquesuesit e DSD/KESH shprehen disa konstatime per pasaktesite e matjeve te monitorimit te masiveve rreshqites ne terren si dhe disa problematika ne lidhje me analizat dhe konkluzionet e arritura ne lidhje me gjendjen e ketyre masiveve dhe kushtet e monitorimit te tyre.

Gjithashtu, gjate mbledhjes u diskutua edhe problematika e sedimenteve ne rezervuaret e HEC Koman dhe Vau i Dejes si dhe masat e marra per zvogelin e ardhjes se tyre ne to. Gjate ketij diskutimi u vu theksi ne analizat qe duhet te kryhen nga KESH ne lidhje me kete problematike, kryerjen e matjeve batimetrike ne keto rezervuare te shoqeruara edhe me analizen e perberjes se ketyre sedimenteve si dhe konkluzione e duhura per menaxhimin e kaskades ne te ardhmen ne funksion te volumeve aktuale te ujut ne keto rezervuare, rritjes se sigurise se digave, ndryshimeve klimatike, zhvillimeve pozitive per monitorimin e rreshjeve dhe prurjeve te zones ne kohe reale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA

Pas diskutimeve të të gjithë antarëve, KKDM

**VENDOSI:**

**1- Ti kërkoj Korporates Eenergitike Shqiptare**

- **Verifikimin ne terren nga specialistet e DSD te te dhenave te matjeve te kryera ne masivet e Poraves dhe Gropaj prane diges se HEC Fierze gjate vitit te fundit si dhe plotesimin e sistemeve te monitorimit te tyre me te gjithe instrumentat dhe matjet e duhura.** Kryerjen nga specialistet e DSD, te pakten nje here ne tre muaj, te matjeve te nivelit te ujit tek piezometrat dhe zhvendosjeve perkatese tek Inklinometrat e instaluara ne keto masive. Keto matje duhet te shoqerohen me matjet gjeodezike te kokave te ketyre instrumentave si dhe analizen e hollesishme dhe te kombinuar te te dhenave te monitorimit per keto masive gjate 5 viteve te fundit. Pas analizes se kujdeshshme te rezultateve te monitorimit dhe plotesimit te sistemeve te monitorimi ne keto masive duhet te shqyrtohen edhe masat e duhura per konsolidimin e masiveve qe mund te krijojn probleme. Keto te dhena dhe analiza perkatese per masivet rreshiqtese si dhe per monitorimin e filtrimeve ne digen e Komanit te shoqruara me grafiket e duhur dhe konkluzionet e nxjerra nga specialistet e DSD duhet te jene pjese e raportit Vjetor 2022 per gjendjen, shfrytezimin dhe monitorimin e digave te Kaskades se lumbit Drin të kerkuar sipas nenit 28 të VKM Nr.147 dhe legjislacionit ne fuqi.
- **Pregatitjen e nje Raporti teknik ne lidhje me ecurine dhe rezultatet e projektit per Sigurine e digave** te financuar nga qeveria Zvicerane. Ne menyre te vecante, ky raport duhet te përshtruaje punen e kryer, rezultatet e arritura dhe mendimin e KESH jo vetem per plotesimin e kerkesave te amendamentit 2 te Marreveshjes perkatese te nenshkruar nga KESH, MIE, MTI, KKDM dhe perfaqsesuesi i ambasades Zvicerane ne Shqiperi ne Maj 2016 por edhe per mundesine e zhvillimit te projekteve te tjera per sigurine e ketyre digave ne te ardhmen . Ky Raport teknik duhet te dorezohet per shqyrtim prane KKDM brenda muajit Nendor 2022
- **Dorezimin e dokumentacionit teknik te duhur dhe projekteve sipas faktit** te zbatuara ne kuader te projektit te financuar nga Banka Boterore dhe KfW sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi
- **Perditesimin e Rregullores se shfrytezimit, Monitorimit dhe Kontrollit te digave dhe rezervuareve te kaskades se lumbit Drin** sipas kerkesave te VKM Nr. 147, date 18.03.2004 "Rregullorja per Sigurine e digave dhe dambave", Neni 29 si dhe Udhezimeve te dhena ne Vendimin Nr. 3 te KKDM , date 19.10.2020
- **Pregatitjen e nje Raporti te plete ne lidhje me vleresimin aktual te Aseteve te 6 digave te kaskades se lumbit Drin.** Ky Raport duhet te dorezohet prane KKDM brenda muajit Nendor 2022.

**2- Ti kërkoj Korporates Eenergitike Shqiptare dhe Ministrise se Infrastruktures dhe Energjisë**

- **Marrjen e masave te duhura dhe pregatitjen e programit te punes per kryerjen e nje kontrolli te plete per te gjithe digat e kaskades se lumbit Drin dhe strukturat e tyre hidraulike ne perputhje me kerkesat e VKM Nr. 147, date 18.03.2004 "Rregullorja per Sigurine e digave dhe dambave", neni 37. Perfaqësues te KKDM do të jenë pjesë përberese e grupit të punës. Programi I punes ne lidhje me kete kontroll duhet te dorëzohet pranë KKDM brënda vitit 2022.**

Ngarkohet Sekretariati Kombëtar i Digave të mëdha (SKDM) si zyrë ekzekutive e KKDM për ndjekjen dhe zbatimin e masave të kërkua të këtë Vendim sipas legjislacionin në fuqi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

**KOMITETI KOMBËTAR I DIGAVE TË MËDHA**

**KRYETARI**

Arjan JOVANI

